



# ANALIZA E ECURISË SË CMIMEVE TË DISA PRODUKTEVE BUJQËSORE NË DISA TREGJE SHUMICE PËR MUAJIN MARS



Çmimi i varietetit Golden Delicious (Madhësia I) të importit është luhatur rreth vleres mesatare 102 lek/kg në tregjet e shumicës në përgjithësi. Grafiku i parë në të majtë tregon ecurinë e çmimit të shumicës për këtë varietet në disa tregje të observuara të shumicës për perjudhën 1-20 Mars.

Ashtu sikurse duket qartë nga grafiku çmimi i Madhësisë I të këtij varieteti ka qenë më i volitshëm në tregun e Korçës ku vlera mesatare e tij ka qenë 92 lek/kg për këtë perjudhë.


Vlera mesatare çmimit në tregun e Tiranës për të njëjtin produkt ka qenë 102.6 lek/kg. Çmimi mesatar në tregun e Fierit për të njëjtën perjudhë, është i përafërt me tregun e Tiranës, 103.6 lek/kg.

Tregu i Lushnjës rezulton me cmime më të larta shumice për të njëjtin produkt, 110.3 lek/kg.

Varieteti Golden Delicios i vendit ka qenë prezent vetëm në tregun e Tiranës dhe të Korçës. Diferenca fillestare e çmimit midis këtyre dy tregjeve prej 36.5% është zvogëluar në fund të muajit.

Çmim mestar në tregun e Korçës për varietetin Golden Delicious ka qenë 55leke/kg ndërsa në tregun e Tiranës 65 lek/kg.

Nga krahasimi i dy grafiqeve vëmë re diferencën në çmim midis mollës së importit dhe asaj të vendit.




Çmimi i domates së serës të importit është luhatur rreth vleres mesatare 140 lek/kg në tregjet e shumicës në përgjithësi. Grafiku i tretë në të majtë tregon ecurinë e çmimit të shumicës për këtë produkt në tregjet e observuara për perjudhën 1-20 Mars. Ashtu sikurse duket qartë nga grafiku çmimi i domates (Madhësia II) të importit ka rezultuar më i ulët në Fier ku domatja e serës e shumicës është shitur mesatarisht me 127.3 lek/kg.

Domatja është shitur mesatarisht në këto vlera edhe në Tiranë: çmimi mesatar i perjudhës 127.8 lek/kg. Në dy tregjet e tjera Korçë dhe Lushnje domatja është shitur më shtrenjtë. Në të gjitha tregjet është vënë re një ngritje e përkohshme e çmimit gjatë dy javëve të para të Marsit për t'u ulur më pas gjatë javës së tretë.

Domatja e serës e vendit ka qenë kryesisht prezente në tregun e Tiranës. Grafiku i katërt shpjegon luhatjen e çmimeve të shumicës në këtë treg sipas madhësisë së domates. Çmimi mesatar i domates së serës të vendit i Madhësisë II rezulton vetëm 83 lek/kg, pra 40% më i lirë se çmimi i të njëjtit produkt të importit.

Çmimi mesatar i Madhësisë I është luhatur rreth 124 lek/kg megjithëse ka pësuar një ulje drastike në dt 11 Mars.

Çmimi mesatar i Madhësisë III është luhatur edhe më pak se madhësitë e tjera rreth vlerës 58lek/kg.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

**KONKURRUESHMËRIA**  
E BUJQËSISË SHQIPTARE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Ministria e Bujqësisë  
Ushqimit dhe  
Mbrojtjes së Konsumatorit